



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec



Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim

Informatë nga DMSH lidhur me situatën e zjarreve gjatë sezonës së verës

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal të Rahovecit,

Njësia profesionale e zjarrfikësve në Rahovec, gjatë muajve korrik dhe gusht 2024, periudhë në të cilën temperaturat kanë qenë tepër të larta, është përballur me situatë alarmante të zjarreve në tërë territorin e komunës, ku janë kapluar nga zjarri dhjetëra hektarë tokë, kryesisht hamullore.

Fatkeqësisht, gjatë kësaj periudhe në fshatin Celinë, si pasojë e rrufesë nga zjarri është kapluar edhe një shtëpi, komisioni e ka vlerësuar dëmin e shkaktuar si dhe komuna me kapacitetet buxhetore i ka dalë në ndihmë familjes së prekur.

Zjarrfikësit tanë që në numër janë vetëm 17, kanë punuar me orë të tëra për lokalizimin dhe fikjen e zjarreve, në terrene tepër të vështira që iu vështirësohej tej mase puna por rrezikohej edhe shëndeti dhe jeta e tyre.

Ligjet e Republikës së Kosovës, e ndalojnë dhe dënojnë ndezjen e zjarreve, si drejtori para sezonës së verës kemi nisur fushatë vetdijësuese për mos-ndezje të zjarreve, kemi apeluar për kujdes të shtuar, lajmërim me kohë dhe denoncim të shkaktarëve, fatkeqësisht, nga të gjitha zjarret që kanë qenë aktive gjatë këtyre muajve, e që dyshohet që janë shkaktuar nga faktori njeri, vetëm një rast ka arritur të zbulohet, ndërsa rastet tjera, në mungesë provash e faktesh fatkeqësisht nuk është arritur identifikimi i keqbërësve.

Në muajin korrik, ekipi i zjarrfikësve intervenoi në 79 vatra të zjarreve, ndër to në malet mes Optrushës, Malishevës dhe Suharekës në një aksion të përbashkët të ekipeve zjarrfikëse dhe autoriteti i pyjeve, u lokalizua zjarri pas shumë orëve përpjekje.

Në muajin gusht, ekipi i zjarrfikësve intervenoi në 80 vatra të zjarreve të natyrave të ndryshme. Me zjarre të shumta jemi përballur edhe në muajin shtator, edhe pse në numër më të paktë në krahasim me muajt korrik dhe gusht, por zjarri në mes fshatrave Zoqisht dhe Hoqë e Madhe mori përmasa të mëdha shkaku edhe i erërave që e karakterizuan ditën. Për shuarjen e plotë të këtij zjarri përveç zjarrfikësve, në ndihmë na dolën edhe qytetarët të cilët vullnetarisht ndihmuan në lokalizimin e zjarrit.

Njësia e zjarrfikësve në Rahovec, ka staf të vogël për të përballuar zjarret e shumta, nuk ka pajisje të avancuara, dhe lokacioni në të cilin gjendet njësia vështirëson punën efikase të zjarrfikësve, për të gjitha këto ne kemi kërkuar ndihmë nga AME e cila edhe i menaxhon njësitë e zjarrfikësve në Kosovë, por nuk kemi marrë përgjigje deri më tani.

Komuna e Rahovecit, ofron gjithë logjistikën për njësinë e zjarrfikësve ne Rahovec në mënyrë që të lehtësohet puna e tyre, e cila sa është e vështirë po aq edhe e rrezikshme për shëndetin dhe jetën e zjarrfikësve, por puna e tyre mbron shëndetin, jetën dhe pronën.

